VENDIM
Nr. 232, datë 30.10.2024

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË "DRIBEN" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1857/8 prot., datë 25.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Driben' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Driben" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1857 prot., datë 3.9.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 187, datë 12.9.2024, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Driben" sh.p.k., për arsye se shoqëria nuk kishte kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.
- Pas kryerjes së pagesës së aplikimit brenda afateve të përcaktuara në Rregullore, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 203, datë 27.9.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.10.2024 dhe 2.10.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 10.10.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 2057 prot., datë 8.10.2024, ERE njoftoi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure.
- Me shkresën nr. 1857/6 prot., datë 4.10.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar të plotësojë informacionin/dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1857/7 prot., datë 11.10.2024, shoqëria ka depozituar informacion dhe dokumentacion plotësues të aplikimit dhe rezulton se ka ende dokumentacion që nevojitet të plotësohet.
- Në nenin 14, pika 3, të rregullores parashikohet, se: "Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë, kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë."
- Për gjithë sa më sipër, me qëllim marrjen e kohës së nevojshme për zhvillimin e një korrespondence vijuese, në lidhje me dokumentacionin e përcjellë nga shoqëria për të saktësuar dokumentacionin financiar (përcjelljen e planit të biznesit të azhurnuar), për të sqaruar mbështetjen financiare dhe informacionin, në lidhje me fillimin e punimeve, vlerësojmë të zgjatet deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë "Driben"

sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Shoqëria duhet të depozitojë sa konstatohet më sipër brenda 5 (pesë) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë "Driben" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin e munguar brenda 5 (pesë) ditëve.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Driben sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti